



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
**IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL**

Anr.172/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma-Socialdemokrate, Lista Ideal, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.172/2025 e datës 24.01.2025.

II. Koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma-Socialdemokrate, Lista Ideal, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbë më lartësi prej 3,700.00 (tremijëeshtatqind) €uro.

III. Detyrohet Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma-Socialdemokrate, Lista Ideal, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 24.01.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datë 23 Janar 2025, aktivistë të Lëvizjes vetëvendosje kanë identifikuar se posteret e kandidatit Nuredin Lushtaku për deputet nga radhët e koalicionit AAK, Nisma,Lista Ideal, janë vendosur në hapësirë publike në ndërtesë të banimit kolektiv në Sheshin e qytetit Skenderaj, dhe me këtë veprim janë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet

e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi që dëshmojnë vendosjen e banerë/posterëve në kundërshtim me LZP.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 26.01.2025, Koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK, Nisma-Socialdemokrate, Lista Ideal, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e subjektit politik LVV, ngase ato janë të pa bazuara dhe në asnjë moment nuk provojnë inkriminimin e këtij koalicioni në shkeljet e pretenduara nga subjekti ankues. Fillimisht, e kontestojmë afatshmërinë e ankesës, ngase ajo s'është bërë brenda afatit të paraparë ligjor, e shto faktin këtu, se ajo edhe po të ishte e afatshme (që në esencë nuk është) përsëri do ishte e pabazuar. Për hirë të korrektësisë, për organin shqyrtyues të kësaj ankesë theksojmë se posterët e bashkangjitur si prova, janë larguar shumë më herët.

Kandidati z. Lushtaku, në kohën kur i kishte vendosur ato, kishin vlerësuar se ka vepruar në harmoni të plotë me nenin 44, par. nën paragrafi 1.2 i LZP, i cili subjekteve politike dhe kandidateve të tyre, ua mundëson që: "1.2. të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore;" Tutje, Rregullorja për Fushatën Zgjedhore nr.07/2024, në nenin 5, par. 1.2, përcakton se: "te publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore", duhet theksuar se, bazuar në fotografitë e paraqitur si prova nga subjekti politik LVV në ankesën e saj, konstatohet se posteret në fjalë janë vendosur në një hapësirë reklamuese, e cila ka qenë e instaluar dhe funksionale edhe para nisjes së fushatës zgjedhore. Po ashtu në përgjigje theksohet se posterët e bashkangjitur si prova janë larguar shumë më herët, ku ka bashkangjitur foto dëshmitë vendi i ngjarjes;

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

- Ankesa është e bazuar.

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se posteri i kandidatit Nuredin Lushtaku, nga radhët e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, është vendosur në hapësirat publike, konkretisht në ndërtesë publike, dhe më të njëjtin veprim Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parashevë: "1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj

një subjekti politik. Një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se "subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në njëzetmijë (20, 000.00) euro.

Me rastin e vendosjes për këtë çështje, paneli ka marrë për bazë përgjigjen ne ankesë të këtij subjekti politik, por që në provat e paraqitura nuk rezulton se është hequr panoja në ndërtesën ku është vendosur, të cilit vend i referohet ankesa. Shqiptimi gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi është bërë duke marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjisacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjisacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.172/2025 datë 26.01.2025



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.*